



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec/ Opština Orahovac/ Municipality Rahovec



Drejtoria Komunale e Arsimit

Odeljenje za Obrazovanje

Department of Education

Nr i Protokolit:04/589

30.04.2025

Rahovec

Duke u bazuar në nenet 77,78,79,80 dhe 81, të Ligjit numër 08L-197 për Zyrtarët publikë, neni 8 të Ligjit të punës Nr. 03L-212, nenin 4,5,6 dhe 7 të Rregullores (QRK) Nr.27/2024 për Procedurat e Konkurrimit për Nëpunësit Teknik dhe Mbështetës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec shpall:

KONKURS PËR PRANIM

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar

Emri i pozitës: Pozitat teknike dhe mbështetëse në Arsim
Institucioni: Komuna e Rahovecit
Njësia: Drejtoria për Arsim
Lloji i pozitës: Nëpunës Teknik dhe Mbështetës
Data e njoftimit: 30.04.2025
Afati për aplikim: 30.04.2025-14.05.2025

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

Personeli shërbyes-teknik, ka për detyrë të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë që janë të përcaktuara në kontratën e punës, si dhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale:

- Arsimi i kërkuar: **Shkollimi i mesëm** (në mungesë të kandidatëve me shkollim të mesëm, mund të vijnë në shprehje kandidatët me shkollim të mesëm të ulët ose me shkollim fillor),
- Përvoja e punës e kërkuar: **Nuk kërkohet.**

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme:

- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;

- b. Shkathtësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët.

5. Pozitat aktualisht të lira:

Nr.	Titulli i Pozitës	Koeficienti	Vendi i punës	statusi
1.	Një (1) punëtor-e teknik dhe mbështetës	4.30	SHFMU-të e Komunës	Vend i lirë

6. Mënyra e aplikimit:

Dokumentacioni i aplikimit, dorëzohet në kopje fizike së bashku me formularin e aplikimit në DKA. Formulari i aplikimit merret në DKA ose shkarkohet nga: <https://konkursi.rks-gov.net>.

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- Rezymeja personale (CV);
- Kopjet e dokumentit personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Kopjet e diplomave të dhënë nga institucionet arsimore (personat që kanë diplomuar Jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit);
- Kopjet e dëshmisë së punësimit; (nëse ka)
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve; (nëse ka)
- Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (lëshuar nga Gjykata themelore, jo me e vjetër se 6 muaj).

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- Vlerësimi i jetëshkrimit (deri në 30 pikë);
- Intervista me gojë (deri në 70 pikë).

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët dhe shpallja e rezultateve përfundimtare:

Përmes ueb faqes së komunës së Rahovecit <https://kk.rks-gov.net/rahovec>.

10. Sqarime shtesë:

- Dokumentet duhet të jenë në kopje sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistës.
- Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).
- Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligjin për Zyrat e Publikë.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e mangëta nuk pranohen.

Rahovec,
30.04.2025



Drejtori: Avni Morina